



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosova

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

DEPARTAMENTI I TREGTISË / DEPARTAMENT TRGOVINE / DEPARTMENT OF TRADE



MASAT DHE BARRIERAT JO-TARIFORE

Maj, 2019

Ky dokument është hartuar me mbështetjen financiare të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e qeverisë së Shteteve të Bashkuara ose të USAID-it.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

PËRMBAJTJA

MASAT DHE BARRIERAT JO-TARIFORE	5
--	----------

Cilat janë këto masa?	6
-----------------------------	---

KU QËNDRON DALLIMI NË MES TË MASAVE

JO-TARIFORE DHE BARRIERAVE JO-TARIFORE?	13
--	-----------

A keni qenë ju subjekt i pengesave të tilla gjatë eksportit të produkteve tuaja?	14
--	----





MASAT DHE BARRIERAT JO-TARIFORE

Tregtia ndërkombëtare e mallrave për çdo vit ka shënuar rritje dhe shkëmbimet tregtare në mes të vendeve të ndryshme pritet të vazhdojnë trendin e tyre të rritjes edhe në të ardhmen.

Përkundër shumë marrëveshjeve tregtare që janë të aplikueshme të cilat kanë për qëllim primar liberalizimin e tregtisë (reduktimin e tarifave doganore) në mes të vendeve të ndryshme si dhe marrëveshjeve të ndryshme ndërkombëtare që synojnë të rregullojnë ceshtjet e tregtisë së lirë, eksportuesit, importuesit por edhe kompanitë që tranzitojnë mallra nëpër vende të ndryshme, vazhdojnë të ballafaqohen me vështirësi dhe barrierat të ndryshme gjatë këtyre transaksioneve. Një pjesë e madhe e këtyre barrierave janë nga ato që nuk përfshijnë aplikim të detyrimeve shtesë doganore (të ashtuquajturat barrierat jo-tarifore), por që me aplikimin e tyre ju shkaktohet kosto shtesë bizneseve.

“Masat jo-tarifore i referohen masave të politikave, përveç tarifave të zakonshme doganore, që potencialisht mund të kenë efekt ekonomik në tregtinë ndërkombëtare të mallrave, me theks të veçantë ndryshimin e sasive të tregtuara, çmimet ose të dyja.”

Cilat janë këto masa?

Masë jo-tarifore konsiderohet cdo veprim që kufizon tregtinë e lirë, përmes aplikimit të veprimeve tjera e që nuk janë tarifore. Kjo nënkupton që aplikimi i këtyre barrierave bëhet jo përmes vendosjes së ndonjë tatimi të ri në import, por duke aplikuar veprime tjera që e vështirësojnë apo e bëjnë më të shtrenjtë importin e atyre produkteve.

“Masat jo-tarifore i referohen masave të politikave, përveç tarifave të zakonshme doganore, që potencialisht mund të kenë efekt ekonomik në tregtinë ndërkombëtare të mallrave, me theks të veçantë ndryshimin e sasive të tregtuara, çmimet ose të dyja” (UNCTAD, 2010).

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD), ka bërë një evidentim dhe klasifikim detal dhe gjithpërfshirës të këtyre masave dhe të njejtat i ka ndarë në ato që quhen:

- Masa teknike dhe
- Masa jo-teknike.

Sipas UNCTAD-it në grupin e masave teknike të aplikuara në import hyjnë një numër i masave për të cilat nje përshkrim i shkurtër është ofruar si në vijim:

- Masat Sanitare dhe Fito-sanitare: nënkuptojnë masat siç janë kufizimet për substancat, kërkesat higjienike, ose masa të tjera për parandalimin e shpërndarjes së sëmundjeve. Në këto masa përfshihen poashtu të gjitha masat e vlerësimit të konformitetit që lidhen me sigurinë e ushqimit, siç janë certifikimi, testimi dhe inspektimi, si dhe karantina.
- Barrierat Teknike ndaj Tregtisë nënkuptojnë masat e tilla si etiketimi dhe masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit. Në këtë nëngrup po ashtu përfshihen vlerësimet e konformitetit që lidhen me kërkesat teknike siç janë certifikimi, testimi dhe inspektimi.
- Inspektimi para transportimit dhe formalitetet tjera nënkuptojnë masat që lidhen me inspektimin para-liferimit dhe formalitetet e tjera të kryera në vendin eksportues përpara liferimit të mallit

Ndërsa sipas UNCTAD-it në grupin e masave jo-teknike të aplikuara në import gjithashtu hyjnë edhe një numër tjetër i masave për të cilat nje përshkrim i shkurtër është paraqitur me poshtë:

- Masat mbrojtëse tregtare kontigjente nënkuptojnë masat të cilat janë masa të zbatuara për të luftuar efektet e veçanta negative të mallrave të importuara në tregun e vendit importues, duke përfshirë masat që synojnë për të luftuar praktikatat e padrejta të tregtisë së jashtme. Ato përfshijnë masat antidumping, kundërbalancuese dhe masa mbrojtëse në import.
- Licensimi jo-automatik, kuota, ndalesat dhe masat e kontrollit sasior nënkuptojnë masat që përfshijnë licencimin, kuotat dhe masat e tjera që kanë për qëllim kufizimin e sasisë së mallrave të tregtuara. Në këtë nëngrup hyjnë edhe ato licenca dhe ndalime importi të cilat nuk janë të lidhura me masat sanitare dhe fitosanitare ose barrierat teknike ndaj tregtisë.

- Masat e kontrollit të cmimit, përfshirë taksa dhe ngarkesa shtesë nënkup-tojnë masat e kontrollit të çmimeve, të cilat zbatohen për të kontrolluar ose ndikuar në çmimet e mallrave të importuara, në mënyrë që ndër të tjera të mbështesin çmimet e produkteve vendore të caktuara kur çmimet e importit të këtyre mallrave janë më të ulëta; përcaktojnë çmimet vendore të disa produkteve për shkak të luhatjeve të çmimeve në tregjet e brendshme ose paqëndrueshmërisë së çmimeve në një treg të huaj; ose për të rritur ose ruajtur të ardhurat tatimore. Kjo kategori gjithashtu përfshin masa tjera prej atyre tarifore, që rrisin koston e importeve në mënyrë të ngjashme (masat para tarifore).
- Masat financiare nënkup-tojnë masat që kufizojnë pagesat e importeve, për shembull kur qasja në valuta të huaja dhe kostoja e këmbimit valutor është e rregulluar me procedura të vecanta. Këtu gjithashtu përfshihen masat

që vendosin kufizime mbi kushtet e pagesës.

- Masat që ndikojnë në konkurrencë nënkup-tojnë masat që ndikojnë në konkurrencë. Këto masa i japin privilegje ekskluzive ose të veçanta një grupi ose më shumë grupeve të kufizuara të operatorëve ekonomikë. Ato i referohen kryesisht masave monopoliste, siç janë tregtia shtetërore ose përmes agjensive të vetme importuese, ose përdorimi i detyrueshëm i shërbimeve kom-bëtare ose transportit.
- Masat në lidhje me investimet e lidhura me tregti nënkup-tojnë masat e lidhura me investimet tregtare, masa që kufizojnë investimet duke kërkuar përfshirje lokale, ose duke kërkuar që investimi të lidhet me eksportet në mënyrë që të balancojë importet.
- Restriksionet në shpërndarje nënkup-tojnë kufizimet në shpërndarje, duke iu referuar masave kufizuese që lidhen me shpërndarjen e brendshme të produkteve të importuara.

- Restriksionet në shërbimet e pas-shitjes nënkuptojnë kufizimet e shërbimeve pas shitjes, për shembull, kufizimet në ofrimin e shërbimeve ndihmëse.
- Subvencionet (përfshijë subvencionet e eksportit) nënkuptojnë masat që kanë të bëjnë me subvencionet që ndikojnë në tregtinë.
- Restriksionet qeveritare në prokurim nënkuptojnë masat kufizuese të prokurimeve qeveritare, i referohet kufizimeve që ofertuesit e huaj mund të hasin kur përpiqen të shesin produktet e tyre tek qeveria vendore.
- Pronësia Intelktuale nënkuptojnë masat në lidhje me pronësinë intelektuale dhe të drejtat e pronësisë intelektuale.
- Rregullat e Origjinës nënkuptojnë masat mbi rregullat e origjinës, grupon masat që kufizojnë origjinën e produkteve ose inputet e tyre.

“Masat financiare nënkuptojnë masat që kufizojnë pagesat e importeve, për shembull kur qasja në valuta të huaja dhe kostoja e këmbimit valutor është e rregulluar me procedura të vecanta.”



Po ashtu, sipas UNCTAD-it, masat e lidhura me eksport nënkuptohen masat e eksportit, grupimin e masave që një vend aplikon për eksportet e saj. Këtu përfshihen taksat

e eksportit, kuotat e eksportit ose ndalimet e eksportit.

Masat Jo-Tarifore të paraqitura në mënyrë tabelare:

Importet	Masat Teknike	Masat Sanitare dhe fitosanitare
		Barrierat teknike ndaj Tregtisë
		Inspektimi para transportimit dhe formalitetet tjera
	Masat Jo-Teknike	Masat mbrojtëse tregtare kontigjente
		Licensimi jo-automatik, kuota, ndalesat dhe masat e kontrollit sasior
		Masat e kontrollit të cmimit, përfshirë taksa dhe ngarkesa shtesë
		Masat financiare
		Masat që ndikojnë në konkurrencë
		Masat në lidhje me investimet e lidhura me tregti
		Restriksionet në shpërndarje
		Restriksionet në shërbimet e pas-shitjes
		Subvencionet (përfshijë subvencionet e eksportit)
		Restriksionet qeveritare në prokurim
		Pronësia Intelktuale
		Rregullat e Origjinës
Eksportet		Masat e lidhura me eksport





KU QËNDRON DALLIMI NË MES TË MASAVE JO- TARIFORE DHE BARRIERAVE JO-TARIFORE?

Në praktikë njerëzit shpeshherë nuk dijnë të bëjnë dallimin në mes të masave jo-tarifore me barrierat jo-tarifore.

Masat jo-tarifore janë veprime ligjore të vendosura përmes ndonjë akti të caktuar ligjor, mund të jenë legjitime dhe jo gjithmonë mund të kenë efekt negativ në tregti. Në shumicën e rasteve aplikimi i këtyre masave nuk kontestohet si e drejtë legjitime e një vendi dhe si veprime përmes së cilës një vend synon të arrijë objektiva legjitime, sikurse është p.sh. mbrojtja e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve ose mbrojtja e ambientit. Edhe pse është e sigurtë që në shumicën e rasteve këto masa e rrisin koston në importin e produkteve ndaj të cilave aplikohen, aplikimi



i këtyre masave automatikisht nuk mund të konsiderohet si barriera në tregti.

Për dallim prej masave jo-tarifore (MJT-e), barriera jo-tarifore (BJT) konsiderohen të gjitha veprimet që kanë si qëllim mbrojtjen e prodhimit vendor ose diskriminimin e produkteve në import. Barrierë jo-tarifore mund të konsiderohet cdo veprim i tepruar në zbatimin e masave jo-tarifore, në të gjitha ato raste kur është evidente se mënyra e veprimit të autoriteteve të një vendi ndaj produkteve në import, e tejkalon atë që është e nevojshme për të zbatuar një masë jo-tarifore të vendosur përmes një akti të caktuar ligjor. Për me tepër, barrierat jo-tarifore përbëhen nga të gjitha pengesat e mundshme tregtare por që nuk janë tarifat.

Në tregtinë ndërkombëtare vendet e caktuara i përdorin barrierat jo tarifore, si një masë për kufizimin e importit nga një vend i caktuar. Disa nga veprimet e autoriteteve që mund të klasifikohen në grupin e barrierave jo-tregtare janë:

- Kontrolle të shpeshta dhe të shtrenjta ndaj mallrave të importit
- Aplikimi i embargos apo sanksioneve në import
- Legjislacion jo konsistent ose aplikim jo adekuat i Legjislacionit
- Jo-Transparencë
- Rregullat e vlerësimit të mallrave nga ana e Doganës
- Procedura të stërgjatura burokratike në import, etj.

A keni qenë ju subjekt i pengesave të tilla gjatë eksportit të produkteve tuaja?

Nëse po, mos hezitoni t'i raportoni këto barrierat tek autoritetet Kosovare ose Organizatat që përfaqësojnë komunitetin e biznesit në Kosovë, dhe të kërkonin ndihmën e tyre për shmangien e këtyre barrierave.



SI MUND TË NA KONTAKTONI?

Departamenti i Tregtisë gjendet në objektin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Adresa: Lagjja e Spitalit,
Rr. "Muharrem Fejza" Zyra: 112 A,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Departamenti i Tregtisë mund të kontaktohet
edhe përmes e-mail adresës: tregtia@rks-gov.net;
ose numrave të telefonit: +383 (0) 38 200 36 623;
+383 (0) 38 200 36 624; +383 (0) 38 200 36 519.